

RIDOMIL GOLD 465.2 SL

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



KUJDES

“Lexo fleteudhëzuesin para përdorimit”

Fungicid me veprim parambrojtës për kontrollin e vrugut në hardhi, perime dhe patate. Metalaxyl-M është fungicid sistemik, selektiv, me veprim kundër oomyceteve. Lëviz në mënyrë akropetale, duke mbrojtur kështu vegjetacionin e ri, duke penguar rritjen e micelit dhe sporogjenezën. Ka kohëzgjatje të madhe veprimi dhe është rezistentë ndaj shpëlarjes. Gjithashtu paraqet efekt shërues.

GRUPI	4	FUNGICID
-------	---	----------

Përmbajtja: *Metalaxyl-M 465.2 gr/Lit (44 % w/w); Kufijtë min/max: 441.9-488.5 gr/Lit (41.8-46.2 % w/w);*

Formulimi: *Koncentrat i tretshëm (SL).*

Masa parambrojtëse:

Të ruhet në vende të sigurta dhe larg fëmijëve.

Lani me kujdes duart pas trajtimit.

Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit.

Vishni pajisje mbrojtëse personale për sytë/fytyrën.

Vishni uniformë mbrojtëse të gjithë trupit, doreza dhe mjete mbrojtëse personale për sytë/fytyrën kur përziemi/ngarkoni produktin.

Vishni uniformë mbrojtëse të gjithë trupit gjatë trajtimit.

Vishni uniformë mbrojtëse të gjithë trupit, të papërshekueshme nga uji dhe doreza, kur trajtoni në kulturat e mbjella me dendësi të madhe në serra.

Në rast të rifutjes në parcelën e trajtuar vishni uniformë mbrojtëse të gjithë trupit dhe doreza.

Në kulturat e mbjella dendur në fushë të hapur, nuk lejohet përdorimi i spërkatësve dore dhe spërkatësve amatore.

Hidhni përmbajtjen/kontejnerin në përputhje me rregulloret në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

Udhëzime të përgjithshme: Të keni në dispozicion paketimin, etiketën ose MSDS e produktit në rast se kërkon ndihmë nga mjeku ose nga Qendra e Helmimeve.

Në rast se merret me organet e frymëmarrjes: Nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër. Në rast të frymëmarrjes së parregullt ose ndërprerjes së frymëmarrjes, filloni frymëmarrjen artificiale. Lëroni viktimën të pushojë dhe mbajeni atë ngrohtë. Njoftoni menjëherë mjekun ose Qendrën e Helmimeve.

Në rast kontakti me lëkurën: Hiqni menjëherë rrobat e ndotura. Lani lëkurën menjëherë me ujë të bollshëm. Nëse acarimi i lëkurës vazhdon, konsultohuni me një mjek. Lani rrobat e ndotura përpara se ti vishni përsëri.

Në rast kontakti me sytë: Shkakton acarim serioz të syve. Shpëllajini me kujdes me ujë për të paktën 15 minuta. Nëse ka lente kontakti, i hiqni ato nëse është e lehtë. Vazhdoni shpëllarjen. Kërkoni ndihmë mjekësore.

Në rast gjëllitje: I dëmshëm nëse gjëllitet. Thërrisni menjëherë Qendrën e Helmimeve ose mjekun. Shpëllajeni gojën.

ANTIDOTI: Antidot specifik nuk njihet. Ndiqni trajtim simptomatik..

Udhëzime për tërheqjen e sigurt të produktit dhe paketimit: Shishet bosh të ambalazhit shpëllahen me ujë nën presion ose shpëllahen tre herë (uji i shpëllarjes hidhet në rezervuarin e pompës spërkatëse) dhe pastaj pasi të jenë shkatërruar paraprakisht duke i shpuar, për të siguruar mos ripërdorimin, të vendosen në pikat e grumbullimit për riciklimin ose rikuperimin e energjisë.

Përdorimi:

(kulturat bujqësore, objekti i luftimit, dozat, mënyra dhe koha e trajtimit, numri i trajtimeve për çdo sezonin kultivimi/intervali i trajtimeve në ditë):

Hardhi (për rrush tavoline e për vere): Për kontrollin e vrugut (*Plasmopara viticola*), me 20 ml/dyn maksimumi ose 120 ml/10 000 m² sipërfaqe gjethore (LWA)*. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-100 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 5^{të} të vërtetë deri në fillim e pjekjes së frutave (BBCH 15-81). Aplikohen 1-2 trajtime në interval 7-10 ditë.

Domate: Për kontrollin e vrugut (*Phytophthora infestans*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 30-100 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 5^{të} të vërtetë deri në vjelje (BBCH 15-84). Aplikohen 1-2 trajtime në interval 7-10 ditë.

Brokol (FH), lulëlakër (FH): Për kontrollin e vrugut (*Hyaloperonospora brassicae*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-80 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 1^{re} të vërtetë derisa kokat të arrijnë formën dhe madhësinë e tyre tipike (BBCH 11-49). Aplikohet 1 trajtim.

Marule: Për kontrollin e vrugut (*Bremia lactucae*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-80 litra/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 1^{re} të vërtetë derisa bima të arrijë madhësinë dhe formën e saj tipike (BBCH 11-49). Aplikohet 1 trajtim.

Çikore, endivie (FH), valerianella (FH): Për kontrollin e vrugut (*Bremia lactucae*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-80 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 1^{re} të vërtetë derisa bima të arrijë madhësinë dhe formën e saj tipike (BBCH 11-49). Aplikohet 1 trajtim.

Bimë mjekësore dhe lule të ngrënshme (FH): Borzilok (FH), Trumzë (FH), *Allium schoenoprasum* (FH): Për kontrollin e vrugut (*Bremia lactucae*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-80 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 1^{re} të vërtetë derisa masa e gjethore të arrijë madhësinë dhe formën e saj tipike (BBCH 11-49). Aplikohet 1 trajtim.

Kastravec (FH): Për kontrollin e vrugut (*Pseudoperonospora cubensis*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-100 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 3^{të} të vërtetë deri në fillimin e pjekjes së frutave (BBCH 13-81). Aplikohet 1 trajtim.

Kastravec (S): Për kontrollin e vrugut (*Pseudoperonospora cubensis*), me 20 ml /dyn maksimumi ose 100 ml/10 000 m² sipërfaqe gjethore (LWA)*. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-100 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 3^{të} të vërtetë deri në vjelje (BBCH 13-81). Aplikohen 1-2 trajtime në interval 7-10 ditë.

Pjepër (FH): Për kontrollin e vrugut (*Pseudoperonospora cubensis*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-100 lit/dyn. Nga shfaqja e lastarëve të parë anësore deri në fillimin e vjeljes (BBCH 21-81). Aplikohen 1-2 trajtime në interval 7-10 ditë.

Pjepër (S), shalqi (FH + S): Për kontrollin e vrugut (*Pseudoperonospora cubensis*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-100 lit/dyn. Nga shfaqja e lastarëve të parë anësore deri në fillimin e vjeljes (BBCH 21-81). Aplikohen 1-2 trajtime në interval 7-10 ditë.

Qepë (e thatë): Për kontrollin e vrugut (*Peronospora destructor*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 20-80 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 5^{të} derisa bulbat të arrijnë madhësinë e tyre përfundimtare (BBCH 15-49). Aplikohet 1 trajtim.

Patate: Për kontrollin e vrugut (*Phytophthora infestans*), me 20 ml/dyn maksimumi. Sasia e tretësirës spërkatëse: 30-60 lit/dyn. Nga shfaqja e gjethes së 1^{re} derisa bima të arrijë madhësinë dhe formën e saj tipike (BBCH 11-49). Aplikohen 1-2 trajtime në interval 7-10 ditë.

Mënyra e përdorimit: Spërkatje gjethore.

Mënyra e përgatitjes së tretësirës spërkatëse:

Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzierjen. Hidhni dozën e duhur të preparatit duke vazhduar përzierjen dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit.

Pastrimi i pajisjeve spërkatëse:

Menjëherë pas përdorimit pastroni me kujdes pajisjet spërkatëse. Zbrazni plotësisht rezervuarin. Shpëlajeni atë dhe të gjitha pjesët e pajisjes spërkatëse tre (3) herë me ujë të pastër, derisa shkuma dhe të gjitha gjurmët e produktit të jenë zhdukur plotësisht.

Përzierja:

RIDOMIL GOLD 465.2 SL duhet të përdoret detyrimisht në një përzierje komplekse për të përmbushur udhëzimet e FRAC për të luftuar rezistencën në lidhje me grupin e fenilamideve dhe në përputhje me atë që është përcaktuar në paragrafin « Kushtet specifike bujqësore, shëndetësore të bimëve ose mjedisit, nën të cilat formulimi mund të përdoret ose përjashtohet ».

Në rastin e përzierjes me produkte të tjera, bëni paraprakisht testin e pajtueshmërisë.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas udhëzimeve të etiketës.

Vërejtje:

Përdorimi në trumzë përfshin edhe përdorimin dytësor në rigon.

Përdorimi në borzilok përfshin edhe përdorimet dytësore në menta dhe nenexhik.

Përdorimi në marule i referohet edhe përdorimeve dytësore në: të gjitha tipet e maruleve dhe të sallatave.

Për të rritur efikasitetin në kulturën e qepës, mund të përdoret në kombinim me një surfaktant.

*Doza LWA:

Në sistemet lineare (me rreshta) të mbjelljes së kulturave me rritje vertikale, për të përcaktuar dozën optimale në lidhje me fazën e zhvillimit të bimëve, llogaritni dozën për dynym duke marrë parasysh përmasat e kulturës bujqësore (lartësinë e vegjetacionit dhe distancën midis rreshtave) dhe dozën LWA si më poshtë:

$$\text{Sipërfaqja gjethore (LWA)} = \frac{2 \times (\text{lartësia e vegjetacionit (metra)} \times 10000 \text{ distanca midis rreshtave (metra)})}{\text{metra}}$$

Për hardhinë:

Lartësia e vegjetacionit është distanca nga dalja e lastarëve deri në majën e bimësisë.

Doza LWA është fikse (120 ml për 10 000 m² LWA), ndërsa doza përfundimtare e aplikuar për dynym rritet duke ndjekur madhësinë e sipërfaqes gjethore, me dozë maksimale të lejuar prej 20 ml/dynym.

Në mënyrë indikative, jipet tabela e mëposhtme e dozave përfundimtare për dynym për hardhinë**:

Distanca midis rreshtave (metra)	Lartësia e vegjetacionit (metra)								
		0,5	0,75	1	1,5	2	2,5	3	3,5
	2,5	5	7	10	14	19	20	20	20
	3	4	6	8	12	16	20	20	20
	3,5	3	5	7	10	14	17	20	20
	4	3	5	6	9	12	15	18	20
	4,5	3	4	5	8	11	13	16	19

** Për rastet që nuk gjenden në tabelën e mësipërme llogaritni dozën duke përdorur formulat e mësipërme.

Për kastravecin në serrë:

Lartësia e vegjetacionit është distanca nga pika e daljes së gjethes ose frutit të poshtëm ekzistuese deri në majën e bimës.

Doza LWA është fikse (100 ml/10 000 m² LWA), ndërsa doza përfundimtare e aplikuar për dynym rritet duke ndjekur madhësinë e sipërfaqes gjethore, me dozë maksimale të lejuar prej 20 ml/dynym.

Në mënyrë indikative, jipet tabela e mëposhtme e dozave përfundimtare për dynym për kastravecin në serrë**:

Distanca midis rreshtave (metra)	Lartësia e vegjetacionit (metra)								
		0,5	0,75	1	1,5	2	2,5	3	3,5
	2,5	4	6	8	12	16	20	20	20
	3	3	5	7	10	13	17	20	20
	3,5	3	4	6	9	11	14	17	20
	4	3	4	5	8	10	13	15	18
	4,5	2	3	4	7	9	11	13	16

** Për rastet që nuk gjenden në tabelën e mësipërme llogaritni dozën duke përdorur formulat e mësipërme.

Kushtet specifike bujqësore, shëndetësore të bimëve ose mjedisit, nën të cilat formulimi mund të përdoret ose përjashtohet:

Menaxhimi i rezistencës: Grupi i Mënyrës së Veprimit – FRAC: Metalaxyl-M: 4

Për të shmangur zhvillimin e rezistencës rekomandohet:

Përdorni produktin në trajtime parambrojtëse.

Të alternohet me fungicidet me mënyra të ndryshme veprimi (grupe të ndryshme FRAC).

Përdoreni herët ose gjatë periudhës së rritjes së vegjetacionit të ri.

Mos i kaloni 2-4 trajtime të njëpasnjëshme me preparate që përmbajnë lëndë vepruese që upërkasin

fenilamideve për çdo kulturë dhe vit bujqësor. Intervallet e trajtimit nuk duhet të kalojnë 14 ditë.

Ndikimi ne mjedis:

Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.

Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.

Mos lani pajisjet spërkatëse pranë ujrave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen përmes sistemit të kullimit.

Intervali kohor i sigurisë midis trajtimit dhe futjes së njerëzve ose kafshëve në parcelën e trajtuar:

Mos hyni në zonën e spërkatur përpara se tretësira spërkatëse të jetë tharë në sipërfaqen e gjetheve. Rihyrja për vjelje me dorë lejohet vetëm pasi të kenë kaluar 2 ditë për vreshtin dhe 10 ditë për lakrat, nga aplikimi i preparatit.

Trajtimi i fundit para vjeljes ose para vendosjes në treg në rastin e trajtimeve pas vjeljes:

Kastravec (FH), pjepër (FH+S), shalqi (FH+S), domate: 3 ditë; Marule, sallatë, çikore endivie (FH), allium schoenoprasum (FH), valerianella (FH), trumzë (FH), rignon (FH), borzilok (FH), menta (FH), menexhik (FH): 10 ditë; Qepë (e thatë), patate, kastravec (S): 14 ditë; Hardhi (për rrush tavoline e për industri), lulëlakër (FH), brokoli (Y): 20 ditë.

Periudha dhe kushtet e ruajtjes:

Produkti mbetet i qëndrueshëm deri në 3 (tre) vjet, në paketimin e tij origjinal të mbyllur, në vende të thata, të freskëta dhe të ajrosura mirë, larg nga rrezet direkte të diellit.

Nr dhe data e regjistrimit: 23, datë 21.8.2025;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 1 lit;

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese:

Tipi i ambalazhit baze: shishe plastike HDPE (High density polyethylene).

Emri dhe adresa e kerkuesit: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Zvicer.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Zvicer.